



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 155 – Tetor – 2016 – Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje gjatë realizimit të disa nga projektet e infrastrukturës, emërtimit të rrugëve, shkollë dhe shtëpi banimi për familjet në nevojë.



Përmbajtja:

U bë përrurimi i aneksit të shkollës në Mirushë	4
Këshilli i Drejtorëve, mbajti mbledhjen e rregullt.....	5
Nga sot, stacioni i autobusëve në Malishevë bëhet pronë komunale	5
KK i Malishevës miratoi buxhetin për vitin 2017	7
Shpërndahen 60 makina mjelëse për blegtorë.....	7
Falë donatorëve, po kompletohen shkollat me kabinate të informatikës	8
Vazhdon rregullimi i rrugëve në Bellanicë	9
Komiteti për shëndetësi, u interesua për punën e DSHMS	10
Rregullohen rrugët në Temeqinë.....	11
Përkujtohen 15 maturantët e Malishevës, në dymbëdhjetë vjetorin e vdekjes tragjike	12
Së shpejti fillojnë vizitat sistematike shëndetësore në shkolla	13
Komuna filloi ndërtimin e pesë shtëpive, ndërsa kryetari ndanë pagën me familjet skamnore	13
Nis vendosja e tabela me emërtimet e rrugëve	14
KPF rekomandoi rregulloren për transparencë për shqyrtim në Kuvend të Komunës	15
U mbajt simpoziumi ndërkombëtar “Terrorizmi dhe terrori”	16
Të rinjtë e Malishevës, promovuan humanizmin dhe kultivimin e ushqimeve tradicionale ...	17
U mbajt tryeza: Përmirësimi e pozitës së të rinjve me aftësi të kufizuara	17
Të gjitha gabimet në emrat e rrugëve do të rregullohen	18
420 bujq përfitojnë pleh kimik për mbjelljet vjeshtore	19
Realizimi i projekteve, drejt përfundimit.....	20
Kryetari Begaj, priti përfaqësuesit e LMT-së në Malishevë	20
KRM falënderon kryetarin Begaj për mbështetje.....	21
Zyrtarët e shoqatës amerikane, të kënaqur me ndërtimin e ujësjellësit në Drenoc.....	22



Situata e sigurisë në Malishevë u vlerësua e qetë dhe stabile	23
KK i Malishevës, miratoi rregulloren për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike	24
Filloi asfaltimi i rrugëve në Dragobil	24
Malisheva reagon për ngritjen e aktakuzës ndaj Fatmir Limajt	25
Asfaltohet rruga që lidhë lagjen Pallanka dhe stadiumin, me qytetin	26
Kijeva dhe dy rrugë të Malishevës, bëhen me ndriçim	26
Hapet tregu i kafshëve	27



U bë përrurimi i aneksit të shkollës në Mirushë

Malishevë, 3 tetor

Sot në fshatin Mirushë, përkatësisht në shkollën “Labinot Krasniqi” , është inauguruar aneksi i



objektit të shkollës dhe nga sot, kjo shkollë, bëhet shkolla e trembëdhjetë në Komunën e Malishevës, që do të mësohet me vetëm një ndërrim. Në ceremoninë e përrurimit të objektit, morën pjesë edhe drejtori komunal i arsimit, Avdi Morina dhe ai i urbanizimit, Ahmet Morina, të cilët i kanë uruar nxënësit, mësuesit dhe banorët e fshatit për këtë objekt të ri shkollor.

“Ne si komunë, jemi duke u angazhuar maksimalisht, që ti ndërtojmë objektet shkollore dhe krahas kësaj, prioritet mbi prioritete është rritja e cilësisë në mësim dhe ky është qëllimi ynë. Ne jemi duke krijuar kushte për mësimdhënie dhe mësimnxënie, por krahas kësaj kërkojmë edhe rritje të cilësisë. Brenda vitit të ardhshëm, pritet të përfundojmë ciklin e ndërtimit të shkollave në të gjitha vendbanimet, dhe kjo bëhet me qëllim të ofrimit të kushteve më të mira, si për nxënës, ashtu edhe për arsimtar dhe në të njëjtën kohë edhe për ngritjen e cilësisë në arsim. Unë sot, ju uroj të gjithëve, që ta gëzoni këtë objekt të ri shkollor”, tha drejtori i arsimit Avdi Morina.

Ndërsa drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, tha se “ krahas investimeve në fusha tjera të infrastrukturës, infrastruktura shkollore, është dhe do të mbetet, prioritet mbi prioritete dhe ne sot, ju urojmë për këtë objekt, i cili besoj që ju ofron kushte më të mira për mësimdhënie”.

Drejtori i shkollës “Labinot Krasniqi”, Shaip Thaçi, duke folur, me rastin e hapjes së këtij aneksi shkollor, e ka falënderuar komunën për këtë investim. “Para luftës në vend, ne si banorë, kemi filluar ndërtimin e saj, për shkak të rrethanave, asnjëherë nuk kemi mundur ta ndërtojmë si duhet. Sot, falë atij angazhim si fshat dhe përkushtimit të Komunës së Malishevës, sot u jetësua kjo shkollë dhe nxënësit, nga sot kanë filluar mësimin”, tha drejtori i shkollës, Shaip Thaçi, i cili i falënderoi të gjithë për kontributin e dhënë, në ndërtimin e shkollës.



Sipas drejtorit të urbanizimit, Ahmet Morina, meremetimi i këtij objekti shkollor, buxhetit komunal i ka kushtuar rreth 25 mijë euro. Gjatë erërave të fuqishme të këtij fillim viti, kulmi i kësaj shkolle ishte dëmtuar tërësisht, ndërsa edhe gjendja brenda objektit, ka qenë jo e mirë, dhe për këtë shkak, Komuna e Malishevës, ka bërë meremetimin e këtij objekti të shkollës.

Këshilli i Drejtorëve, mbajti mbledhjen e rregullt

Malishevë, 3 tetor

Sikur çdo të hëne, edhe sot, Këshilli i Drejtorëve, nën drejtimin e nënkryetarit të Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, ka mbajtur mbledhjen e rregullt, ku është raportuar për punën dhe aktivitetet e drejtorive, gjatë javës së kaluar dhe planifikimet për javën në vijim, ku u tha se po vazhdojnë të realizohen disa nga projektet, si në infrastrukturë, ashtu edhe në bujqësi.

Sa i përket fushës së bujqësisë, u tha se po vazhdohet me disa projektet e kësaj drejtorie, siç janë ndërtimi i stallave, pastaj përkrahja për bujqit, për mbjelljet vjeshtore, si dhe janë duke u bërë të gjitha përgatitjet për mbjelljet vjeshtore, të këtij viti.

Në këtë mbledhje, gjithashtu u tha se po vazhdohet me realizimin e projekteve kapitale, në infrastrukturën në përgjithësi.

Po ashtu u bë e ditur, se gjatë kësaj fundjave, ekipet malishevase, që bëjnë pjesë në garat e ndryshme, kryesisht janë të treguar të suksesshme, sidomos në futboll dhe volejboll, ku ekipet tona, kanë dalë fitues gjatë përballjeve.

Nga sot, stacioni i autobusëve në Malishevë bëhet pronë komunale

Malishevë, 5 tetor

Agjencia Kosovare e Privatizimit nënshkroi sot marrëveshjen e bashkëpunimit me komunën e Malishevës për transferimin e të drejtave dhe





detyrimeve në lidhje me asetet e NSh “Kosovatrans”-Njësia në Malishevë.

Drejtori menaxhues i AKP-së, Ekrem Hajdari i shoqëruar nga dy zëvendës drejtorët, Valbona Dibra dhe Avni Jashari, ia dorëzuan marrëveshjen për transferimin e kësaj ndërmarrje kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj me ç’rast u mbajt edhe ceremonia e pranimit dorëzimit të ndërmarrjes “Kosovatrans” nga autoriteti i AKP-së tek autoriteti i Komunës së Malishevës.

Marrëveshja e nënshkruar rregullon bashkëpunimin lidhur me transferimin e asetëve dhe detyrimeve të ndërmarrjes shoqërore “Kosovatrans” në Prizren, Njësia Punuese “Stacioni i Autobusëve”, në Malishevë nga administrimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit tek Komuna e Malishevës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike dhe pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve.

Marrëveshjes në fjalë i ka parapri kërkesa formale nga ana e Komunës së Malishevës e datës 9 shkurt 2016, për transferimin e ndërmarrjes shoqërore “Kosovatransi” nën autoritetin e Komunës, ndërsa Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur me datë 26 maj 2016 e ka aprovuar nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të AKP-së dhe Komunës së Malishevës në lidhje me transferimin e asetëve të NSh “Kosovatrans-Njësia/Stacioni i autobusëve në Malishevë tek Komuna e Malishevës, në bazë të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike (nr.04/L-111).

“Kosovatrans”, ka qenë e regjistruar si ndërmarrje shoqërore, mirëpo në vazhdimësi ka kryer funksione në interes publik të qytetarëve.

Transferimin i kësaj ndërmarrje nga autoriteti i AKP-së tek organet e Komunës është në pajtim me Ligjin e AKP-së, ku neni 5 paragrafi 2 mundëson që ndërmarrjet dhe asetet e tyre të barten në përgjegjësi dhe administrim të një organi tjetër publik, përmes një Rregullore ose Ligji që është në fuqi dhe që është shpallur nga një autoritet kompetent publik në Kosovë.



KK i Malishevës miratoi buxhetin për vitin 2017

Malishevë, 6 tetor

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur sot, me shumicë të votave, ka votuar për projekt buxhetin e vitit 2017. Anëtarët e Kuvendit të Komunës, me 16 vota për dhe asnjë kundër, e kanë votuar propozim buxhetin. Herën e parë, buxheti i propozuar, nuk ka kaluar me shumicë të votave, ndërsa në këtë mbledhje të jashtë radhës (urgjente), është miratuar me shumicë të votave.



Fillimisht, anëtarëve të Kuvendit të Komunës, ju është drejtuar Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili ju bëri thirrje që ta votojnë këtë projekt buxhet, pasi është një buxhet i planifikuar mirë, pa ndikime politike dhe në shërbim të qytetarëve të Komunës së Malishevës. “Kemi planifikuar investime, përkatësisht kemi hartuar listë të investimeve, duke u bazuar në kërkesat e vet banorëve të Komunës së

Malishevës”, ka thënë Begaj.

Pas debatit të zhvilluar, me shumicë të votave, përkatësisht 16 vota për (NISMA, VV dhe AAK), dhe pas asnjë kundër, është miratuar projekt buxheti për vitin 2017 (PDK dhe LDK, nuk kanë marrë pjesë në votim).

Shpërndahen 60 makina mjelëse për blegtorë

Malishevë, 7 tetor



Krahas përkrahjes së fermerëve, përmes projekteve të ndryshme, sot, Komuna e Malishevës, përkatësisht



Drejtoria për Bujqësi, ka shpërndare edhe gjashtëdhjetë makina mjelëse për blegtorët e Komunës së Malishevës. Sipas drejtorit për bujqësi, Haxhi Krasniqi, kjo përkrahje është në kuadër të përkrahjes së vazhdueshme, për blegtorët, përmes së cilës do të motivohen blegtorët për rritjen e krerëve të bagëtive të trasha dhe të imta.

“Synim i yni si drejtori dhe si qeveri komunale, është përkrahja e blegtorëve, ku përmes ndihmës me mjete konkretizuese, i motivojmë blegtorët që të shtojnë numrin e bagëtive dhe me këtë rast, rrjedhimisht edhe furnizimin e tregut me qumësht dhe produkte të qumështit, e po ashtu edhe në rritjen e numrit të të punësuarve”, tha drejtori Krasniqi.

Drejtori Krasniqi, po ashtu ka bërë të ditur se kjo përkrahje me makina mjelëse, është bërë për gjashtëdhjetë blegtorë, përkatësisht për pesëdhjetenjë fermer që mbajnë gjedhe (lopë), katër fermer që mbajnë dele dhe pesë fermer që mbajnë dhi.

Ky projekt ka kushtuar 12 420 euro dhe është bërë me bashkëfinancim me blegtorët, të cilët kanë marrë pjesë me tridhjetë përqind të shumës, ndërsa Komuna ka paguar pjesën tjetër prej shtatëdhjetë përqind.

Falë donatorëve, po kompletohen shkollat me kabinete të informatikës

Malishevë, 10 tetor

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur sot, mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ku drejtorët e drejtorive kanë raportuar për aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe planifikimet për javën në vijim. Në këtë mbledhje, u njoftua se falë disa donatorëve, po vazhdohet kompletimi i kabineteve të informatikës në disa shkolla të Komunës së Malishevës.

Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Avdi Morina, ka njoftuar, se Kryqi i Kuq, ka kompletuar me kompjuter, kabinetin e informatikës në sh.f.m.u. “Imer Krasniqi” në Carrallukës, ndërsa shumë shpejt pritet të kompletohen kabinetet e informatikës edhe në tri shkollat e fshatit



Drenoc, pasi një organizatë holandeze, e ka premtuar këtë donacion. Me këtë rast, drejtori Morina, i ka falënderuar të gjithë donatorët për këtë përkrahje.

Sa i përket investimeve kapitale dhe realizimit të këtyre projekteve, Kryetari i Komunës, Ragip Begaj, ka kërkuar nga drejtoritë përkatëse, që të shtohet intensiteti i punimeve dhe të përfundojnë projektet, para përfundimit të vitit, ashtu siç kanë qenë të planifikuara.

Por drejtorët e drejtorive përkatëse, kanë njoftuar se projektet janë duke vazhduar sipas planifikimeve dhe vetëm në tri projekte, ka ngecje, për shkak të pengesave nga pronarët e tokave, në dy kanalizime të ujërave atmosferik dhe në rrethojën e QKMF-së. Përndryshe, të gjitha projektet tjera, janë duke vazhduar, si në ndërtimin e shkollave, rrugëve kanalizimeve, pastaj ndërtimi i stallave, kurse disa projekte, pritet të fillojnë ditët në vijim, siç janë subvencionet në bujqësi.

Edhe sa i përket përgatitjeve për sezonin dimëror, janë duke u bërë përgatitjet, sidomos në furnizimin me dru për ngrohje, e që pritet të fillojë furnizimi gjatë kësaj jave, si dhe furnizimi me lëndë tjera djegëse në institucione shkollore dhe institucione tjera.

Vazhdon rregullimi i rrugëve në Bellanicë

Malishevë, 11 tetor



të fillojnë të realizohen edhe projekte tjera në Bellanicë.

Në kuadër të investimeve në rregullimin e infrastrukturës rrugore, në Komunën e Malishevës, sot ka filluar implementimi edhe i një projekti, përkatësisht ka filluar rregullimi i dy rrugëve në dy lagje të fshatit Bellanicë, njëra në lagjen Hoxhaj edhe tjetra në lagjen e Kafexhollëve. Në fillimin e punimeve në këtë projekt, ka marrë pjesë edhe drejtori i urbanizmit Ahmet Morina, i cili tha se brenda pak ditëve, do



Këto dy rrugë, të cilat i rregullon Komuna e Malishevës, pas zgjerimit, do të shtrohen me kubëza, pasi janë rrugë brenda lagjeve. “Është duke u bërë një punë e mirë dhe kjo bëhet në kuadër të përpjekjeve tona, për rregullimin e infrastrukturës së përgjithshme në Komunën e Malishevës, ndërsa në Bellanicë, krahas këtyre rrugëve, shumë shpejt do të fillojnë të realizohen edhe projekte tjera”, tha drejtori Morina.

Ndërsa banorët e këtyre lagjeve, e kanë falënderuar komunën, për këtë investim, të nevojshëm për ta, pasi lagjet janë të tipit të grumbulluar dhe rrugët kanë nevojë të rregullohen.

Përndryshe, fshati Bellanicë, të gjitha rrugët kryesore i ka të asfaltuara dhe një pjesë e madhe edhe me trotuar, dhe njihen si një fshat, banorët e të cilit, gjithmonë janë aktiv me vetiniciativa për rregullimin e rrugicave, por edhe rruajtjen e hapësirës së gjelbër brenda fshatit.

Komiteti për shëndetësi, u interesua për punën e DSHMS

Malishevë, 11 tetor

Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Familje të Dëshmorëve, Invalid dhe Veteranë të Luftës si dhe Persona me Aftësi të Kufizuara, organ i Kuvendit të Komunës së Malishevës, kryesuar nga kryesuesi i këtij komiteti, Veton Telaku, ka mbajtur mbledhjen e radhës, si dhe kanë vizituar drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ku janë njohur me raportin e punës në gjashtë mujorin e parë, si dhe me çështje tjera, në sektorin e shëndetësisë dhe të Qendrës për Punës Sociale.



Anëtarët e këtij komiteti, janë pritur dhe janë njoftuar me aktivitetet e tyre, nga drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Hajdin Berisha dhe nga drejtori i Qendrës për Punës Sociale, Blerim Begaj, të cilët edhe i kanë dhënë sqarimet e tyre, në interesimin e anëtarëve të këtij komiteti.

Interesimi më i madh ishte për çështjet e verifikimit të aplikantëve për tu futur në skemë sociale, cilët persona apo familje e kanë këtë të drejtë dhe mënyrat e aplikimit, e po ashtu edhe për formën e



dhënies së barnave (të cilat janë jashtë listës esenciale) nga ana e komunës, për kategoritë e caktuara, si dhe për funksionimin e punkteve shëndetësore në Komunën e Malishevës.

Anëtarët e komitetit, po ashtu falënderuan drejtorinë, për gatishmërinë e tyre, si në ofrimin e raporteve të punës, ashtu edhe në gatishmërinë e përgjegjësve për tu takuar me anëtarët e komitetit.

Rregullohen rrugët në Temeqinë

Malishevë, 13 tetor



Komuna e Malishevës, ka filluar realizimin edhe të një projekti për fshatin Temeqinë, përkatësisht, ka filluar zgjerimi dhe më pas asfaltimin e rrugëve brenda fshatit, duke e kompletuar edhe këtë fshat me infrastrukturën rrugore. Në fillimin e punimeve, morën pjesë edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj me drejtorin e urbanizmit, Ahmet Morina.

Me këtë rast, kryetari Begaj, i ka uruar banorët e Temeqinës për rregullimin e rrugëve, dhe tha se “Komuna e Malishevës, është e përkushtuar, që brenda mundësive të krijoj kushte sa më të mira për jetesë, për të gjithë banorët e saj, përfshi edhe fshatrat e largëta, siç është Temeqina”.

“Qëllim i yni është rritja e mirëqenies dhe krijimi i kushteve sa më të mira për jetesë, edhe në fshatrat e thella apo të largëta, pasi të gjithë banorët e Komunës së Malishevës, janë të barabartë dhe rrjedhimisht edhe do të trajtohen njëjtë, pa dallime”, tha Begaj.

“Rrugët në lagjet e fshatit Temeqinë, kapin një gjatësi prej 2.3 kilometra dhe janë pjesë e planifikimeve komunale, në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në Komunën e Malishevës”, ka thënë drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, sipas të cilit, rrugët kanë nevojë të zgjerohen dhe të bëhet baza e tyre, e më pas edhe asfaltimi, ndërsa punimet, do të kryhen sipas afateve të parapara. Drejtori Morina, gjithashtu ka bërë të ditur, se krahas rrugëve në Temeqinë, janë duke i rregulluar rrugët, edhe në shumë vendbanime të Malishevës.



Përkujtohen 15 maturantët e Malishevës, në dymbëdhjetë vjetorin e vdekjes tragjike

Malishevë, 14 tetor



Sot, në “Lëndinën e lotëve”, aty ku janë të varrosur pesëmbëdhjetë maturantët e gjimnazit “Abdyl Frashëri” (tani “Hamdi Berisha”), në dymbëdhjetë vjetorin e vdekjes tragjike, janë përkujtuar dhe janë bërë homazhe, nga mijëra nxënës, qytetar e zyrtarë komunal. “Edhe pas dymbëdhjetë viteve, dhimbja është e njëjtë për maturantët, që humbën jetën në lulen e rinisë”, ka thënë nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, gjatë homazheve.

Pikërisht në ora 14:14, mijëra qytetarë, nxënës, familjarë e zyrtarë të Komunës së Malishevës, kanë mbajtur një minutë heshtje dhe më pas kanë bërë homazhe, për pesëmbëdhjetë maturantët e gjimnazit, të cilët, humbën jetën tragjikisht, më 14 tetor 2004, në ora 14:14, në Fushë Arrëz, të Shqipërisë, gjatë kthimit nga ekskursioni në Shqipëri.

Kjo tragjedi, është edhe tragjedia më e rëndë e ndodhur në Kosovën e pasluftës, pasi humbën jetën pesëmbëdhjetë maturant, në lulen e rinisë, ndërsa u lënduan dhjetëra të tjerë.

Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, i shoqëruar nga drejtori i arsimit, Avdi Morina dhe drejtor e zyrtarë tjerë komunal, kanë bërë homazhe në varrezat e maturantëve dhe e kanë ndarë dhimbjen me familjarët e tyre, që siç tha nënkryetari Mazreku, “edhe pas pesëmbëdhjetë viteve, dhimbja është e njëjtë, ndërsa kujtimi për ta, nuk do të harrohet kurrë”.

Në këtë tragjedi, e kanë humbur jetën këta maturant: Berat Suka, Esat Hajrullahu, Elgadaf Zabelaj, Mifail Morina, Rifat Hoxha, Xhevdet Sertolli, Visar Kafexholli, Agron Berisha, Ajet Rrahmanaj, Esat Rexhaj, Labinot Morina, Lulzim Kastrati, Megezton Sadiku, Rruhi Ulluri dhe Xhevet Sahitaj.



Së shpejti fillojnë vizitat sistematike shëndetësore në shkolla

Malishevë, 17 tetor

Sot, është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, të cilën e udhëheqë Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ndërsa në këtë mbledhje, gjatë raportimit të drejtorëve, u tha se së shpejti do të fillohet me realizimin e projektit të vizitave sistematike shëndetësore, nëpër shkollat e Komunës së Malishevës, e gjithashtu u raportua edhe si një javë e suksesshme në sport, ku ekipet malishevase, kanë treguar rezultate të mira.

Drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha, tha se janë në përgatitje të fillimit të projektit për realizimin e vizitave shëndetësore sistematike, në shkollat e Komunës së Malishevës, ku përfshin nxënësit e klasave, të para, të pesta dhe të nënta. Drejtori Berisha, gjithashtu ka bërë të ditur se janë furnizuar me vaksina kundër gripit sezonal.

Ndërsa në fushën e sportit, drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi, ka njoftuar për suksese të ekipeve të Malishevës, në garat e ndryshme, duke filluar me klubin e notit “Besa”, të cilët janë shpallur kampion në kampionatin e Kosovës, në pishinë të mbyllur (25 metra), për kategorinë e juniorëve dhe pionierëve. Po ashtu, edhe ekipi i volejbollit është duke vazhduar me rezultate të mira, sikur edhe ekipi i futbollit dhe ai i futsallit.

Sa i përket realizimit të projekteve kapitale, drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, tha se janë duke vazhduar me realizimin e projekteve, kryesisht në infrastrukturë, por herë pas here, këto projekte mund të kenë gëcje, për shkak të kushteve atmosferike.

Në fushën e ekonomisë drejtori Vesel Krasniqi, ka thënë se janë në përfundime sipër të rregullores për taksa, për vitin 2017, ndërsa buxheti i komunës, është shpenzuar në masën shtatëdhjetë përqind.

Komuna filloi ndërtimin e pesë shtëpive, ndërsa kryetari ndanë pagën me familjet skamnore

Malishevë, 18 tetor



Sot, ka filluar implementimi i projektit të Komunës së Malishevës, për ndërtimin e pesë shtëpive për familjet në nevojë, si dhe ndërtimin e shtatë kulmeve për rastet e njëjta sociale. Po ashtu, Kryetari i Komunës së Malishevës, gjatë vizitave në familjet me gjendje të rëndë sociale, ka ndihmuar disa nga familjet, me mjete nga paga e tij mujore.

Shtëpia e parë që ka filluar të ndërtohet, është e ajo e familjes së Mahmut Zogajt nga Llazica, ndërsa në fillimin e punimeve ka marrë pjesë Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori urbanizimit Ahmet Morina, të cilët krahas fillimit të ndërtimit të shtëpive, edhe i kanë vizituar këto familje.

“Mundësitë buxhetore të komunës nuk janë të mjaftueshme për ndërtimin e të gjitha shtëpive për ata që kanë nevojë, por çdo vit, ne po mundohemi që sadopak ti ndihmomë këto familje, që nuk e kanë të zgjidhur problemin e strehimit. Një prej këtyre është edhe familja Zogaj, dhe në emër të Komunës së Malishevës, uroj ta gëzoni këtë shtëpi”, tha kryetari Begaj.

Sipas drejtorit të urbanizimit, Ahmet Morina, implementim e këtij projekti e mbikëqyrë drejtoria që ai drejton, dhe në këtë vit, do të ndërtohen pesë shtëpi, ndërsa shtatë të tjera do të ndihmohen me kulme, kurse i tërë projekti, buxhetit komunal i kushton rreth 75 mijë euro.

Po ashtu, gjatë ditës së sotme, kryetari Begaj, ka vizituar edhe disa nga familjet në nevojë, përkatësisht familje me kushte jo të mira socio ekonomike, ndërsa rastet më të rënda, kryetari i ka ndihmuar me mjete monetare, nga paga e tij mujore.

Nis vendosja e tabela me emërtimet e rrugëve

Malishevë, 19 tetor



Ka filluar vendosja e tabelave me emërtimet e rrugëve, në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës, ndërsa i tërë procesi, varësisht prej kushteve atmosferike, planifikohet të përfundoj



brenda dhjetë ditëve. Fillimin e realizimit të këtij projekti, e ka parë nga afër edhe i pari i Malishevës, Ragip Begaj, i cili e ka quajtur “një projekt me rëndësi të madhe, pasi nga tani do të jetë më i lehtë orientimi i qytetarëve dhe kryerja shërbimeve tjera, qoftë komunale, postare, ashtu edhe i shërbimeve elektronike”.

“Kjo është shumë e rëndësishme, pasi qytetari ka një adresë, ka një emërtim të rrugës së tij dhe çdo gjë është më e lehtë, për të gjitha shërbimet komunale, pastaj postare por edhe shërbimet elektronike, sepse i kanë të saktësuara adresat e tyre”, ka thënë Begaj.

Ndërsa drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, ka bërë të ditur se ky projekt do të përfundoj brenda dhjetë ditëve, varësisht nga kushtet atmosferike, pasi shtyllat janë vendosur paraprakisht, e tani bëhet vendosja e tabelave me emrat e rrugëve. Morina, gjithashtu ka bërë të ditur, se cilësia e shtyllave dhe tabelave, është me standarde evropiane.

KPF rekomandoi rregulloren për transparencë për shqyrtim në Kuvend të Komunës

Malishevë, 19 tetor

Komiteti për Politikë dhe Financa, i drejtuar nga kryesuesi Aziz Thaçi, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt, ku pas shqyrtimeve, ka dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës. Në mesin e rekomandimeve, është shqyrtimi i Rregullores për Transparencë, e cila pritet që pas shqyrtimit në KK, të del në diskutim publik.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit e ka rekomanduar për shqyrtim edhe raportin e të hyrave dhe shpenzimeve komunale, për periudhën janar-shtator-2016. Raportin para anëtarëve të KPF-së, e ka prezantuar drejtori për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, ndërsa anëtarët e KPF-së e kanë quajtur raport shumë i kompletuar, dhe shpenzimin e buxhetit e kanë vlerësuar në harmoni me planifikimin e buxhetit të miratuar në Kuvendin e Komunës.



U mbajt simpoziumi ndërkombëtar “Terrorizmi dhe terrori”

Malishevë, 20 tetor



Dje në Malishevë, është mbajtur simpoziumi ndërkombëtar “Terrorizmi dhe terrori”. Ku aktivitete në Malishevë, është në kuadër të simpoziumit që e ka organizuar shoqata e shkrimtarëve dhe kritikëve shqiptar. Në këtë simpozium morën pjesë shkrimtar nga vende të ndryshme të botës, të cilët paraprakisht janë pritur nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Në këtë takim, si dhe një fjalimin e mbajtur në këtë simpozium, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, tha se “beson që do ta krijoni një bindje tjetër për Kosovën dhe këtë bindje ta përcillni në vendet e juaja, në mënyrë që edhe vendet që nuk kanë njohur Kosovën, ta njohin”. “Jemi një popull që e dimë mirë se çka është terrori, pasi ne e kemi përjetuar në mënyrën më vrazhdë të mundshme dhe vetëm ata popuj që e kanë përjetuar terrorin e kuptojnë më së miri. Pavarësisht vuajtjeve, ne duam që ju ta njihni shtetin e Kosovës dhe të bëhemi popuj miq, pasi nga armiqësia nuk ka dobi”, tha Begaj.

Kryetari i shoqatës së shkrimtarëve dhe kritikëve të Evropës, Daniel Leuwers nga Franca, falënderoi Komunën e Malishevës, për mundësinë që ju është dhënë, për këtë simpozium, si dhe për mundësinë e organizimit të kësaj ngjarje poetike, ku shkrimtarët dhe poetët , do të kenë mundësi të shkëmbejnë idetë e tyre, në fushën e poezisë, si dhe dhënien e mesazheve kundër terrorizmit dhe për paqe, mes të gjithë popujve në botë”.

Ndërsa Alla Pollosina, nga Rusia, foli për “Qendrën e Tolstoit” në Moskë, si dhe për angazhimin e tyre, për tolerancë dhe kundër terrorizmit, duke marrë shembuj nga thëniet dhe veprimet e Tolstoit. Edhe Bluma Finkelstain nga Izraeli, tha se vjen nga një vend që është në luftë, por që sipas saj, edhe Izraeli edhe Palestina kanë të drejtë të vendosin për fatin e tyre, sikur që edhe Kosova ka të drejtën e saj për të vendosur për fatin e saj, ashtu siç e ka bërë. “Uroj që Kosova të ketë njohje dhe ta ketë vendin e saj në OKB, sikur edhe Palestina që e ka të njëjtën të drejtë”, tha shkrimtarja Finkelstain.



Në këtë aktivitet, morën pjesë shkrimtar nga Shqipëria, Franca, Rusia, Izraeli, Spanja, Belgjika, Zvicra e vende të tjera. Pas mbajtjes së orës letrate, ku morën pjesë edhe shkrimtar e poet nga Malisheva dhe komunat tjera të Kosovës, u shfaq edhe dokumentari i shkrimtares Yaël Armanet, e që lidhet me luftën mes Izraelitëve dhe Palestinezëve, vrasja e burrit të saj dhe falja që ka bërë kjo familje, dokumentar përmes së cilit, dërgohet mesazhi i tolerancës dhe kundër terrorizmit.

Të rinjtë e Malishevës, promovuan humanizmin dhe kultivimin e ushqimeve tradicionale

Malishevë, 20 tetor



Organizuar nga Kuvendi i të Rinjve të Malishevës, sot është mbajtur një panair me karakter humanitar, në të cilin janë prezantuar ushqime tradicionale shqiptare, dhe me shitjen e këtyre gatimeve, do të sigurohen ushqime për familjet në nevojë. Këtë iniciativë të të rinjve e kanë përkrahur edhe disa furra dhe kompani që veprojnë në Malishevë.

Këtë panair të ushqimeve tradicionale, e ka vizituar edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku, i cili ju ka dhënë mbështetje të rinjve, për

këtë aksion edhe humanitar, por edhe në kultivimin e traditës sonë. Nënkryetari Mazreku, i ka inkurajuar të rinjtë për këto lloj të aksioneve vullnetare, me karakter humanitar.

Sipas kryetarit të Kuvendit të të Rinjve të Malishevës, Lulzim Buzhala, ky panair dhe ky aksion është mirëpritur nga ana e qytetarëve. Buzhala i ka falënderuar për pjesëmarrjen e tyre të gjithë të rinjtë vullnetarë, dhe në mënyrë të veçantë furrat “Rina” dhe Diellza”, si dhe supermarket “Pajtimi”, të cilët gjithashtu kanë ndihmuar dhe kanë prezantuar gatimet e tyre në këtë panair.

U mbajt tryeza: Përmirësimi e pozitës së të rinjve me aftësi të kufizuara



Malishevë, 20 tetor

Organizuar nga Organizata për Persona me Distrofi Muskulore e Kosovës (OPDMK), dhe Qendra e Rinisë, sot në Qendrën e rinisë në Malishevë, është mbajtur një tryezë diskutimi për përmirësimin e pozitës së të rinjve me aftësi të kufizuara.



Në këtë tryezë, të rinjtë kanë ngritur problemet që përballen ata si dhe nevojën për përmirësimin e pozitës së tyre në shoqëri. Po ashtu u bë dhe prezantimi i doracakut “ Shoqëria dhe qasja ndaj personave me aftësi të kufizuara “.

Antigona Shestan- drejtoreshë ekzekutive e OPDMK-së, theksoi se duhet mbështetur edhe më shumë të rinjtë me nevoja të veçanta.

Në këtë tryezë ishin të pranishëm përfaqësues të komunës, zyrtari për rini Mehdi Krasniqi dhe përfaqësuesja e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Bukurie Krasniqi.

Të gjitha gabimet në emrat e rrugëve do të rregullohen

Malishevë, 21 tetor

Të nderuar qytetarë të Komunës së Malishevës,

Drejtorja e Urbanizimit, i njofton të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, se gabimet që mund të jenë bërë në tabelat me emrat e rrugëve, do të përmirësohen.

Emërtimi i rrugëve, ka qenë një proces i gjatë dhe shumë i vështirë, ndërsa tani jemi në fazën e vendosjes së tabelave me emrat e të gjitha rrugëve. Projekti i vendosjes së tabelave me emra, financohet nga Bashkimi Evropian dhe bëhet me standarde evropiane dhe për këtë qëllim, emrat në tabela shtypen në një nga vendet e Bashkimit Evropian, ku rrjedhimisht edhe mund të ketë gabime, prandaj, lusim të gjithë banorët, që i vërejnë këto gabime, të paraqiten në Drejtorinë e Urbanizimit për rregullimin e tyre.



Zyrat e Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Malishevës, janë të hapura nga ora 08:00 deri në ora 16:00, andaj lutem të gjithë ata që kanë ankesa në tabelat me emrat e rrugëve, të paraqiten në drejtori, për përmirësimin e gabimeve, ku edhe mund ti marrin udhëzimet për mënyrën e paraqitjes së ankesave të tyre dhe procesin e përmirësimit të emrave të rrugëve.

Emërtimi i rrugëve është bërë, sipas propozimeve të bëra nga vet banorët, ndërsa në fund janë miratuar nga ana e Kuvendit të Komunës, por pavarësisht kësaj, mund të jenë bërë gabime, si në aspektin e drejtshkrimit, ashtu edhe në ngatërrimin e emrave, prandaj, mos bëni veprime individuale për heqjen e tabelave, por të gjitha gabimet apo defekt që i vëreni, ju lutem që të paraqiteni në drejtori, për përmirësimin dhe eliminimin e çdo gabimi të mundshëm.

420 bujq përfitojnë pleh kimik për mbjelljet vjeshtore

Malishevë, 21 tetor



Drejtorja për Bujqësi në Komunën e Malishevës, sot ka filluar shpërndarjen e plehut kimik për 420 përfitues. Ky subvencion i Komunës së Malishevës, bëhet për bujqit, me qëllim të përkrahjes për mbjelljet vjeshtore, përkatësisht mbjelljes së grurit. Në fillimin e shpërndarjes së plehut kimik, mori pjesë edhe i dyti i Komunës së Malishevës, nënkryetari Rexhep Mazreku, i cili ka përshëndetur bujqit përfitues.

“Në kuadër të përpjekjeve të qeverisë komunale për ta përkrahur bujqësinë, ne sot po shpërndajmë edhe këtë sasi të plehut kimik, në mënyrë që sadopak ti përkrahim bujqit në mbjelljet vjeshtore, përkatësisht mbjelljen për mbjelljen e grurit”, tha nënkryetari Mazreku.

Ndërsa drejtori i drejtorisë për bujqësi, Haxhi Krasniqi, ka bërë të ditur se ky projekt, ka një shumë prej rreth 20 mijë eurove dhe financohet nga buxheti komunal i Malishevës, ndërsa përfitues janë 420 bujq, me nga 150 kilogram, ose në tërësi 63 mijë kilogram pleh kimik, për mbjellje vjeshtore.



Realizimi i projekteve, drejt përfundimit

Malishevë, 24 tetor

Shumica e projekteve janë drejt përfundimit të tyre, u tha sot në mbledhjet e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të cilën e drejtoi nënkryetari i Komunës së Malishevës, Raxhep Mazreku. Kështu kanë deklaruar drejtorët e drejtorive, gjatë raportimit të tyre, për aktivitete e javës së kaluar dhe planifikimit të aktiviteteve për javën në vijim.

Në këtë mbledhje u tha se gjatë fundjavës kanë përfunduar asfaltimet e dy rrugëve, ndërsa gjatë kësaj jave pritet të përfundojnë edhe disa rrugë tjera. Po ashtu edhe procesi i ndërtimit të shtëpive për familjet në nevojë, është duke shkuar mirë, sikur edhe procesi i vendosjes së tabelave me emrat e rrugëve.

Edhe në fushën e bujqësisë, është duke vazhduar subvencionimi i bujqve me pleh kimik, sikur edhe ndërtimi i stallave është drejt përfundimit.

Në fushën e arsimit, u bë e ditur se sot pritet të bëhet montimi i pajisjeve për kabinetet e informatikës në tri shkollat e fshatit Drenoc dhe gjatë javës të pritet të hyjnë në funksion këto kabinete, të cilat janë donacion.

Po ashtu në këtë mbledhje u bisedua edhe për përgatitjet dimërore që janë duke u bërë, siç është furnizimi i mirë me lëndë djegëse për institucionet që janë përgjegjësi e komunës, si dhe për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë dimrit.

Kryetari Begaj, priti përfaqësuesit e LMT-së në Malishevë

Malishevë, 24 tetor

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot ekipin e ri të LMT-KFOR-it në Malishevë, me të cilët ka biseduar për çështje të ndryshme, e mbi të gjitha për bashkëpunimin mes Komunës së Malishevës dhe LMT-së. Kryetari Begaj, e ka njoftuar udhëheqësin e ekipit të ri të LMT-së, Igor Macoratti, për situatën e përgjithshme në Malishevë, si dhe për angazhimet e komunës, në raport me qytetarët.



Begaj e Macoratti, biseduan edhe për çështje tjera, me interes të ndërsjellë, ku situata e sigurisë u vlerësua e mirë. Po ashtu u bisedua edhe për çështje tjera, si situata e përgjithshme socio-ekonomike, arsimit, shëndetësia, si dhe ambienti dhe mbrojtja e ambientit.

Në këtë takim, u tha se bashkëpunimi mes komunës dhe LMT-së, do të vazhdoj, ashtu si ka qenë deri më tani, i mirë dhe i ndërsjellë, ndërsa kryetari Begaj, ju ka thënë, se “përderisa jetoni dhe veproni në Malishevë, atëherë edhe ju jeni si të gjithë qytetarët e saj, pjesë e Malishevës, andaj edhe bashkëpunimi ynë do të vazhdoj”.

KRM falënderon kryetarin Begaj për mbështetje

Malishevë, 25 tetor



Kuvendi i të Rinjve të Malishevës (KRM), përmes një letër falënderimi, ka falënderuar Kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, për mbështetje të aktiviteteve të tyre. Këtë letër falënderim, kryetarit Begaj, ja dha sot kryetari i Kuvendit të Rinjve të Malishevës, Lulzim Buzhala, i cili gjithashtu falënderoi edhe sektorët tjerë të komunës, për mbështetjen në aktivitetet e tyre.

“Rinia është potenciali më i madh që kemi ne si komunë, prandaj edhe përkrahja për aktivitetet e juaja dhe të organizatave rinore, është prioritet dhe obligim për ne”, tha me këtë rast kryetari Begaj. Kryetari, gjithashtu tha se do të vazhdoj përkrahja për aktivitetet rinore, të cilat kanë karakter edukativ dhe arsimor dhe kundër dukurive negative.

Nga ana tjetër, kryetari i KRM, Lulzim Buzhala, ka falënderuar edhe sektorët tjerë, si drejtorinë për kulturë, rini dhe sport, pastaj drejtorinë e arsimit, për mbështetjen e vazhdueshme në aktivitetet e KRM.



Zyrtarët e shoqatës amerikane, të kënaqur me ndërtimin e ujësjellësit në Drenoc

Malishevë, 27 tetor

Përfaqësuesit e organizatës amerikane, e cila ka investuar në ndërtimin e ujësjellësit në Drenoc, gjatë tërë ditës së djeshme kanë qëndruar në Malishevë, për tu njoftuar në detaje për ndërtimin e ujësjellësit në Drenoc. Delegacioni është pritur nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili i ka njoftuar me të gjithë procedurat, deri në përfundim të projektit, ndërsa zyrtarët e kësaj shoqate, janë ndarë të kënaqur me realizimin e projektit.



Në ndërtimin e ujësjellësit në Drenoc, krahas komunës, kanë ndihmuar me një shumë prej rreth njëqindmijë euro, edhe shoqata e kishës “Jezu Krisht” në SHBA.

Fillimisht kryetari Begaj, i ka njoftuar ata për tërë procesin, si dhe i ka falënderuar për këtë investim, që ka ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e mirëqenies së banorëve të Drenocit. “Ju falënderoj juve si organizatë, si dhe popullin amerikan, për përkrahjen e

vazhdueshme për Kosovën dhe veçanti për Malishevën”, ju ka thënë Begaj.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e kësaj organizate, tha se “është kënaqësi që ti ndihmojmë njerëzit dhe jemi shumë të lumtur që ju keni përparuar dhe ky është qëllim i yni, që ti ndihmojmë njerëzit”.

Më pas, kryetari Begaj, i ka shoqëruar përfaqësuesit e kësaj organizate gjatë vizitës në Drenoc, si dhe në disa vende tjera të Malishevës.

Përfaqësuesit e kësaj organizate, janë ndarë të kënaqur me realizimin e projektit për ndërtimin e ujësjellësit në Drenoc.



Situata e sigurisë në Malishevë u vlerësua e qetë dhe stabile

Malishevë, 27 tetor

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), i drejtuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt, ku është shqyrtuara situata e sigurisë së përgjithshme në Malishevë, si dhe në veçanti siguria në shkollat e Komunës së Malishevës. Situata e sigurisë, i vlerësua e qetë, stabile dhe pa tendencë të prishjes së kësaj situatë.

“Të gjithë ne, e kemi obligim të angazhohemi për sigurinë në komunën tonë dhe të gjithë së bashku, mund ta ruajmë primatin e të qenit komuna më e sigurt në Kosovë”, tha në fjalën e tij, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Komandanti i stacionit policor në Malishevë, kapiteni Halil Morina, duke u bazuar në të dhënat policore, e vlerësoi të qetë situatën e sigurisë së përgjithshme. Sipas kapitenit policor, Morina, gjatë nëntë muajve të këtij viti ka rënie të rasteve kriminale për njëzetedy përqind. Sipas tij, kjo situatë, është rezultat i bashkëpunimit të mirë me qytetarët.

Pikë e veçantë e këtij takimi, ishte edhe siguria në shkolla, ku sipas drejtorit të arsimit, Avdi Morina, gjatë këtij viti, është shënuar vetëm një incident, në Qendrën e Kompetencës, mirëpo kjo shkollë, tanimë, në mënyrë arbitrare, është nën menaxhimin e Agjencisë për Shkollimin Profesional. Përndryshe, sipas drejtorit Morina, në shkollat e Komunës së Malishevës, nuk janë shënuar raste të incidenteve, kurse objektet shkollore, pothuajse të gjitha të ndërtuara pas luftës, janë me standarde, që përfshin edhe aspektin e sigurisë, siç janë daljet emergjente dhe çështjet tjera teknike, që lidhen me sigurinë.

Edhe Policia e Kosovës, lidhur me sigurinë në shkolla, thanë që janë në vëzhgim të vazhdueshëm dhe gjatë procesit mësimor, i kanë të shtuara patrullimet përreth shkollave.

Në mbledhjen e sotme të KKSB-së, u bisedua edhe për përgatitjet dimërore, në veçanti për masat preventive, në rastet emergjente, që mund të shkaktohen, si pasojë e të reshurave, sikur që kemi pasur vërshimet e janarit të këtij viti.



KK i Malishevës, miratoi rregulloren për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike

Malishevë, 28 tetor

Sot është mbajtur mbledhja e njëmbëdhjetë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Malishevës, të cilën e drejtoi kryesuesi Aziz Thaçi. Në këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës, dhanë betimin dy anëtar të rinj të kuvendit, Gazmend Krasniqi, i cili zëvendësoi Faton Krasniqin, nga radhët e IQM-së (NISMA) dhe Ramadan Thaçi, i cili zëvendësoi Durim Krasniqin nga radhët e LDK-së. Në këtë mbledhje, janë shqyrtuar e miratuar raporte, si dhe janë marrë disa vendime.

Fillimisht, KK i Malishevës, me shumicë të votave, ka miratuar kërkesat e LVV, për pjesëmarrje në Komitetin për Politikë dhe Financa, si dhe për formimin e Komitetit për Bujqësi. Po ashtu, KK, vendosi edhe për iniciimin e procedurave për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore së punës së Kuvendit të Komunës.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, pas shqyrtimit, me shumicë të votave, ka miratuar raportin e zyrës së prokurimit publik, për periudhën janar-16.08.2016. Pas kësaj, Kuvendi i Komunës, ka shqyrtuar edhe raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-shtator 2016.

Gjithashtu, pas shqyrtimit, KK i Malishevës, e dërgoi në diskutim publik, Rregulloren mbi Transparencën në Komunën e Malishevës, si dhe pas rishqyrtimit, është miratuar Rregullorja për Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Varrezave Publike.

KK ka marrë vendim edhe për regjistrimin e një rruge publike, kërkesë e banorëve të lagjes së re, si dhe për zhvendosjen e një rruge në fshatin Jançist, me qëllim të mbrojtjes së varrezave publike.

Filloi asfaltimi i rrugëve në Dragobil

Malishevë, 28 tetor



Sot, në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në Komunën e Malishevës, pas rregullimit, ka filluar edhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Dragobil. Asfaltimin e rrugëve, e kanë



parë nga afër edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, të cilët i kanë uruar banorët, për përfundimin e rrugëve.

“Rregullimi i rrugëve, bëhet në kuadër të investimeve në projektet kapitale, përmes së cilave rritet edhe mirëqenia e qytetarëve dhe ne jemi të përkushtuar në rritjen e mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Malishevës”, tha kryetari Begaj, i cili më pas i përgëzoi banorët.

Drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, tha se janë rregulluar dhe po asfaltohen të gjitha rrugët brenda fshatit, dhe “ si drejtori, janë drejt përfundimit të të gjitha projekteve të infrastrukturës në Komunën e Malishevës, të parapara për këtë vit”.

Kryetari i fshatit Dragobil, Salih Paçarizi, në emër të fshatit e ka falënderuar Komunën e Malishevës dhe kryetarin Begaj, për asfaltimin e rrugëve, të cilat janë në shërbim të qytetarëve, ndërsa fshati, çdo ditë po e ndryshon pamjen, përmes këtyre investimeve.

Ditë më parë, në Dragobil, ka përfunduar edhe ndërtimi i nënkalimit, në afërsi të shkollës.

Malisheva reagon për ngritjen e aktakuzës ndaj Fatmir Limajt

Malishevë, 28 tetor

Kryetari i Komunës së Malishevës, ka reaguuar sot në mbledhjen e KK të Malishevës, lidhur me ngritjen e aktakuzës ndaj Fatmir Limajt. “Kjo është tendencë e barazimit të luftës së UÇK-së, me krimet që kanë bërë serbët ndaj shqiptarëve, dhe kjo është shqetësuese, pasi ndaj Limajt po ngritën aktakuza të vazhdueshme, lidhur luftën çlirimtare”, tha kryetari Begaj, i cili shprehi shqetësimin e tij, edhe lidhur me aktakuzat dhe dënimet ndaj luftëtarëve tjerë të lirisë.



Lidhur me aktakuzat lidhur me Fatmir Ljmajn, por edhe ndaj të tjerëve, kanë reaguar edhe anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Asfaltohet rruga që lidhë lagjen Pallanka dhe stadiumin, me qytetin

Malishevë, 31 tetor




Ka përfunduar zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës Malishevë-Dragobil (lagja Pallanka), e cila lidhë këtë lagje, stadiumin e qytetit dhe palestrën sportive, me qendrën komunale, përkatësisht qytetin e Malishevës. Kjo rrugë është rregulluar në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në Komunën e Malishevës.

Një pjesë e lagjes Pallanka, ka qenë e shkëputur me rrugë nga pjesa tjetër dhe lëvizja e banorëve, ka qenë e vështirësuar. Po ashtu përgjatë kësaj rruge, është ndërtuar edhe stadiumi i futbollit të madh, si dhe palestra sportive, duke e bërë të domosdoshme, rregullimin e kësaj rruge, si për banorët, ashtu edhe për sportistët dhe klubet sportive.

Asfaltimin e rrugës, e ka inspektuar edhe drejtori i urbanizmit, Ahmet Morina, i cili tha se “ asfaltimi i rrugës ka qenë nevojë e domosdoshme, në rend të parë për banorët e kësaj lagjeje, por edhe për sportistët, sportdashësit dhe klubet sportive”. “Në këtë pjesë, është orientuar ndërtimi i objekteve sportive, prandaj rregullimi i infrastrukturës rrugore, është i domosdoshëm”, tha Morina.

Kijeva dhe dy rrugë të Malishevës, bëhen me ndriçim

Malishevë, 31 tetor



Në kuadër të realizimit të projekteve kapitale, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për të gjithë qytetarët, në aspektin e rregullimit të infrastrukturës, si dhe me qëllim të rritjes së sigurisë së përgjithshme, Komuna e Malishevës, ka rregulluar ndriçimin në fshatin Kijevë (rruga kryesore) si dhe në dy rrugë në qytetin e Malishevës.

Sipas drejtorit të urbanizimit, Ahmet Morina, gjatë javës që kemi lënë pas, ka përfunduar rregullimi i ndriçimit në Kijevë, ku rregullimi i ndriçimit ka qenë i domosdoshëm dhe kërkesë e banorëve, pasi Kijeva është një nga vendbanimet më të frekuentuara, sepse shërben si qendër për shumë fshatra, si dhe ka shumë nxënës të cilët vijojnë mësimin e mesëm, në shkollën

profesionale.

Po ashtu, me kërkesën e vazhdueshme të banorëve të qytetit të Malishevës, përkatësisht banorëve të rrugës “William Walker” dhe të rrugës “Jahir Mazreku”, është rregulluar ndriçimi edhe në këto dy rrugë.

Hapet tregu i kafshëve

Malishevë, 31 tetor

Sot është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, e cila është drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, Rexhep Mazreku. Në këtë mbledhje, drejtorët e drejtorive, kanë prezantuar aktivitetet e tyre javore, ndërsa lajmin e mirë e ka dhënë drejtorja e inspektoratit, ku ka njoftuar se nga kjo javë do të hapet tregu i kafshëve, pasi ka kaluar rreziku i përhapjes së sëmundjes së gungore të kafshëve.

Sipas drejtorit të inspektoratit, Fadil Shala, AVUK-u, e ka njoftuar drejtorinë, se nga tani mund të hapet tregu i kafshëve, i cili ishte ndaluar tash e disa muaj, në kuadër të masave për



parandalimin e përhapjes së sëmundjes gungore të kafshëve. Ky është prej lajmeve më të mira që kanë marrë shitësit dhe blerësit e kafshëve, pasi konsiderohet se ka kaluar rreziku i përhapjes së kësaj sëmundjeje.

Në këtë mbledhje, edhe drejtori për buxhet, Vesel Krasniqi, tha se janë në rrugë të mbarë të përfundimit të suksesshëm të këtij viti buxhetor, ndërsa drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, ka thënë se janë drejt përfundimit të dhjetëra projekteve, disa prej të cilave tani kanë përfunduar gjatë javës, duke i përmendur shumë rrugë, kanalizime, ndriçim të rrugëve dhe të tjera.

Në fushën e bujqësisë, drejtori Haxhi Krasniqi, tha se për shkak të kushteve të mira atmosferike, bujqit po vazhdojnë me mbjelljen e grurit.